

## Shenimet per Pasqyrat Financiare per vitin e mbyllur me 31.12.2021

### 1. Informacion i Pergjithshem:

"UFO" Sh.p.k, eshte themeluar si nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me Vendim Nr.4392 , date 24.05.1994 te Gjykates se Rrethit Tirane. Selia e shoqerise eshte ne Bulevardin Zogu i Pare , Ish-Pallati I Kultures " Ali Klemendi " Tirane. Kapitali i Rregjistruar i shoqerise eshte 460.000.000 leke dhe zoterohet 100 % nga Ortaku Z.Astrit Veliaj.

Veprimtaria kryesore shoqerise eshte Aktiviteti ne fushen e Arsimit te Larte.

#### Permbledhje e politikave kontabel

#### Bazat e pergatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare te vitit 2021 janë pregatitur në te gjitha aspektet ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Kontabilitetit (SNK) dhe ligjin Nr.9228 date 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" , i ndryshuar . Pasqyrat Financiare jane pregatitur ne monedhen vendase, Lekë Shqiptar (lekë).

#### Parimet kontabile më domethënëse që janë përdorur nga shoqeria, janë si më poshtë:

##### **Njohja e te ardhurave dhe shpenzimeve**

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri te mjaftushme ne marrjen e perfitimeve. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përlogaritet me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara. Shpenzimet njihen atehere kur ato sigurohen prej te treteve dhe ne te njejtin ushtrim kontabel me te ardhurat e lidhura.

##### **Monedhat e huaja**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit të në datën e bilancit. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e kostos historike dhe nuk rivlerësohen. Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqeria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2021 jane

1 Euro = 120.76 leke dhe 1 USD=106.54



## Shenimet per Pasqyrat Financiare per vitin e mbyllur me 31.12.2021

### **Tatimin mbi fitimin**

Shpenzimi per tatimin mbi fitimin perfaqeson shumen e tatimit per tu paguar per vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshem per vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshem i cili ndryshon nga fitimi tregetar qe raportohet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve, sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjistacionit fiskal. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin per vitin ushtrimor 2021 eshte 15 %.

### **Kërkesat për t'u arkëtuar**

Kërkesat për t'u arkëtuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogari të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arkëtuar në parë regjistrohen në bilanc me kosto të amortizuar. Kostoja e amortizuar e kërkesave për t'u arkëtuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet e krijuara për rënie në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre neto të realizueshme (e cila raportohet, për shembull në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

### **Pasivet financiare**

Huat e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u shlyer në parë, në përgjithësi, mbahen me koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme (për shembull, të raportuar në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

### **Aktivet e qëndrueshme të trupëzuara**

Aktivet afatgjata materiale (AAM-të) bazohen ne modelin e koston. Në bilanc, një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Amortizimi është llogaritur mbi bazen e metodes lineare per aktivet afatgjata Jo-materiale ,ndersa aktivet afatgjata materiale me bazen e vleren se mbetur per pjesen tjetër te aktiveve te qendrueshme. Normat e perdorura per AA Jo-materiale deri ne 15 % te vleres fillestare dhe per ndertesat deri ne 5 % ,pajisje informatike deri ne 25 % dhe aktivet e tjera deri ne 20% te vleres se mbetur.

### **Gjendjet e inventaret**

Vlerësimi ne hyrje i inventareve behet me cmimet e blerjes dhe ne rastet kur eshte e aplikueshme u shtohen kostot e shkaktuara per te sjelle inventaret ne kushte magazinimi. Gjendjet e inventarit ne pasqyrat financiare paraqiten me kostot e blerjeve te fundit te ushtrimit qe nga drejtimi eshte çmuar si vlera neto te realizueshme.



## Shenimet per Pasqyrat Financiare per vitin e mbyllur me 31.12.2021

### 2- Shenimet qe shpjegojne zerat e bilancit .

#### 1- Mjete monetare

Gjendjet e mjetet monetare ne banke dhe arke te koverturea ne leke ne datat 31 Dhjetor 2021 dhe 31 Dhjetor 2020 jane si me poshte:

Emertimi i Llogarise	Monedha	Gjendja ne 31.12.2021	Gjendja ne 31.12.2020
		Ne leke	Ne leke
Llogari bankare	LEK, EUR, USD	189,596,355	122,382,940
Arka ne leke	LEK, EUR,USD	23,644,917	30,506,687
<b>Shuma</b>		<b>213,241,272</b>	<b>152,889,627</b>

Gjendjet e llogarive konfirmohet me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike te monedhave. Tepricat e shprehura ne monedhe te huaj, jane konvertuar ne leke duke perdorur kursin e kembimit te fundit te vitit sipas BSH i cili eshte : EURO =120.76 leke dhe USD =106.54

Shoqeria ka llogari rrjedhese ne Alfa Bank , Raiffesisen Bank , Union Bank , Societe Generale dhe FIB .

#### 2. Te drejta te arketueshme afatshkurtra

Kerkesat , te drejtat e arketueshme dhe aktive te tjera financiare, ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel te vitit 2021 deklarohen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2021	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020
Kliente	104,432,302	101,707,422
Kerkesa nga njesite ku ka interesa pjesemarrese	131,818,485	47,673,322
Te tjera te drejta e kerkesa	108,898,808	126,630,252
<b>Shuma</b>	<b>345,149,595</b>	<b>276,010,996</b>

Ne Llogarine "Kliente" jane pasqyruar shumat e paarkteuara te klienteve ( studenteve) .

Ne kerkesa nga njesite ku ka interesa pjesemarrese , ne shumen prej 131.818.485 leke ka te beje me shoqerine Vokopola Energji, Albania College, Hotel Colombo, ku shoqeria zoteron kuotat.

Llogarine " Te tjera te drejta dhe kerkesa " jane kerkesa ndaj "UTV Education " shpk ne shumen prej 70.458.436 leke, Tatimi fitimi paguar me teper ne shumen prej 4.105.967 leke , pjesa tjetere eshte

Paradhenie personeli , paradhenie furnitori per blerje dhe mardhenie me doganat .

#### 3. Shpenzime te shtyra .

Shpenzimet e shtyra ne vitin 2021 paraqiten si me poshte :

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2021	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020
Shpenzime te shtyra	110,730,262	143,805,535
<b>Vlera neto</b>	<b>110,730,262</b>	<b>143,805,535</b>

Shpenzime te shtyra perfaqesojne shpenzime te veprimtarise qe u perkasin periudha te ardhshme .



**Shenimet per Pasqyrat Financiare per vitin e mbyllur me 31.12.2021**

**4. Aktive financiare Afatgjata .**

Aktivet financiare afatgjata ne vitin 2021 paraqiten si me poshte :

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2021	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020
Tituj pronesie ne njesite e brenda grupit	200,000	-
<b>Vlera neto</b>	<b>200,000</b>	<b>-</b>

Shoqeria zoteron 100 % shoqerite Albania College shpk dhe Hotel Colombo Berat shpk me kapital themeltar prej 100.000 leke secila .

**5. Aktivet Afatgjata Materiale(AAM-te)**

Gjendjet dhe levizjet e aktiveve afatgjata materiale ne pasqyrat financiare te 31.12.2021 paraqitet si vijon:

Gjendjet dhe levizjet	Toka dhe Ndertesa dhe Aktive te Qerave	Pajisje zyre, Inf dhe tjera	Mjete Transporti	Totali
A Kosto totale e AAM me 31.12.2020	4,472,877,640	685,962,450	77,650,504	5,236,490,594
Shtesat	258,701,781	33,952,872	2,943,410	295,598,064
Pakesimet	-	-	27,712,500	27,712,500
<b>Kosto totale e AAM me 31.12.2021</b>	<b>4,731,579,422</b>	<b>719,915,322</b>	<b>52,881,414</b>	<b>5,504,376,158</b>
B Amortizimi i AAM-ve 31.12.2020	625,871,259	466,763,548	47,835,781	1,140,470,587
Amortizimi ushtrimit	191,302,830	51,701,916	6,404,456	249,409,202
Amortizimi per daljet e AAM-ve	-	-	18,013,125	18,013,125
<b>Amortizimi i AAM-ve 31.12.2021</b>	<b>817,174,089</b>	<b>518,465,464</b>	<b>36,227,112</b>	<b>1,371,866,664</b>
D Vlera neto e AAM-ve 01.01.2020	3,847,006,382	219,198,903	29,814,723	4,096,020,007
<b>Vlera neto e AAM-ve 31.12.2020</b>	<b>3,914,405,333</b>	<b>201,449,859</b>	<b>16,654,302</b>	<b>4,132,509,494</b>

Vlerat dhe klasifikimi ne grupe i AAM-ve te pasqyruara ne bilanc dhe ne tabelen e mesiperme jane te perputhura me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve fizike qe shoqeria e ka kryer ne fund te muajit Dhjetor 2021. Si politike kontabel per kontabilizimin dhe spjegimin e AAM-ve, shoqeria ka zgjedhur modelin e koston. Vleresimi fillestar ne momentin e marrjes ne inventar eshte bere me koston e marrjes dhe ne daten e mbylljes se bilancit paraqiten me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvleresimi. Ne AAM ( Ndertesat ), perfshihen edhe aktivet e qerave sipas IFRS 16 te llogaritura dhe amortizimi i tyre per vitin 2021. Vlera neto e aktiveve te qerave ne 31.12.2021 sipas IFRS 16 jane vleren prej 99.831.536 leke .

Drejtimi mendon se pergjithesisht per kete ushtrim kontabel, nuk ka shenja te renies ne vlere te AAM-ve dhe nuk ka llogaritur zhvleresime.



## Shenimet per Pasqyrat Financiare per vitin e mbyllur me 31.12.2021

### 6. Detyrime afatshkurtra:

Ne detyrimet afatshkurtra ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel te vitit 2021 paraqiten si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2021	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020
Detyrime per kredi afatshkurter		
Furnitore	7,494,133	58,553,599
Detyrime te Qerave	103,625,135	98,826,605
Sigurime Shoqerore dhe Shendetsore	4,757,956	5,430,083
TAP per tu paguar	1,399,560	1,080,137
Tatim ne Qera dhe ne Burim	3,165,872	2,496,750
TVSh per tu paguar	-	0
Debitore dhe kreditore te tjere	3,623,657	16,067,657
<b>Shuma</b>	<b>124,066,313</b>	<b>182,454,831</b>

"Furnitorëve" pasqyron detyrimet ndaj furnitoreve per blerjen e sherbimeve dhe mallrave pa u likjuar ne fund te ushtrimit. Shoqeria ka pergatitur inventaret kontabel dhe shuma e llogarise sintetike eshte e barabarte me shumen e llogarive analitike te mbajtura per cdo furnitor. Drejtimi mendon se te drejtat e furnitoreve jane te vleresuara realisht. "Sigurimet shoqerore dhe shendetsore", TAP dhe Tatim ne Burim dhe te Personeli, jane detyrime te muajit Dhjetor 2021 te cilat jane paguar brenda Janar 2021.

### 7. Te ardhura te shtyra

Te ardhura e shtyra ne vitin 2019 paraqiten si me poshte:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2021	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020
Te ardhura te shtyra	211,087,310	194,905,720
<b>Vlera neto</b>	<b>211,087,310</b>	<b>194,905,720</b>

Te ardhurat e shtyra pasqyrojne jane shumen e tarifave te studenteve, te cilat jane paguar por si te ardhura u perkasin periudhave te vitit 2021 pasi nuk eshte kryer sherbimi i mesimdhenises.

### 8. Hua Afatgjata

Hua Afatgjata ne vitin 2021 paraqiten si me poshte:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2021	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020
Hua Afatgjata		
Hua ne banka	751,189,877	696,259,722
<b>Vlera neto</b>	<b>751,189,877</b>	<b>696,259,722</b>

Ne fund te vitit 2021 gjendja e principalit te kredive Afatgjata (ne Euro te konvertuara me kursin e kembimit prej leke /Euro) jane ne shumen prej 751.189.877 leke nga e cila:

- 630.430.077 leke, kredi ne OTP Bank,
- 120.760.000 leke, kredi ne Union Bank.



## Shenimet per Pasqyrat Financiare per vitin e mbyllur me 31.12.2021

### 9. Kapitalet e Veta

Kapitali i regjistruar i shoqerise i paraqitur ne bilanc , eshte i njejte me ate te percaktuar ne statutin e shoqerise dhe vendimet e depozituara ne QKR. Kapitali i nenshkruar eshte 460.000.000 leke , i ndare ne 100 kuota me vlere nominale 4.600.000 leke /kuota. Gjate ushtrimit kontabel te vitit 2021 nuk ka pasur ndryshime ne kapitalin themeltar.Totali i Kapitaleve te Veta te Shoqerise me 31.12.2021 eshte ne shumen prej 3.715.487.123 leke , i cili perbehet nga Kapitali i nenshkruar ne shumen prej 460.000.000 leke , Rezerva Ligjore 5.176.116 leke, Rezerva te tjera per Investime 3.139.826.717 leke dhe Fitimi neto i vitit financiar 2021 ne shumen prej 110.484.291 leke.

### 10. Fitimi (humbja) e vitit financiar

#### ▪ Te ardhurat

Te ardhura e realizuara gjate ushtrimit, sipas segmenteve (kategorive) te biznesit paraqitet si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2021	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020
<b>Te ardhurat</b>		
Te ardhura nga Arsimi	830,391,221	1,000,593,381
Te ardhura te tjera	66,713,255	45,987,242
<b>Vlera neto</b>	<b>897,104,476</b>	<b>1,046,580,623</b>

Të ardhurat nga "Shitja e Sherbimeve ne Arsim" jane te ardhurat nga studentet per mesimdhenien dhe "Te ardhurat e tjera" jane te ardhura nga Klinika Dentare , Bari , Shitja e Librave dhe Hoteleri . Paraqitja ne pasqyrat financiare e te ardhurave dhe shpenzimeve eshte bere sipas Natyres se tyre. Veprimtaria e sherbimeve ne arsim eshte e perjashtuar nga TVSH-ja. Totali i shifres se afarizimit te Deklaruara ne FDP eshte 922.985.441 leke dhe ka nje diference prej 25.880.965 leke nga totali i te ardhurave sipas PASH , pasi gjate vitit 2021 kemi rritje ne te ardhurave te shtyra ( 16.181.590 leke) e cila kalon ne ulje te shumes se te ardhurave te vitit 2021 dhe vlera e mbetur e shitjeve te aseteteve, pasi shitja e aseteteve eshte pasqyruar me vlere neto ( vlera e mbetur 9.699.375 leke) .

### 11. Shpenzimet e veprimtarise kryesore.

Shpenzimet kryesore te Veprimtarise per vitin 2021 dhe 2020 jane :

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2021	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020
<b>Shenzimet</b>		
Kosto e Punes	217,815,719	245,293,521
Materiale te konsumuara	52,752,528	15,341,360
Shpenzime operative dhe administrative	203,406,265	373,253,875
Amortizimi I ndertesave dhe Aktiveve te qerave	249,409,202	212,702,460
Shuma	<b>723,383,714</b>	<b>846,591,216</b>



## Shenimet per Pasqyrat Financiare per vitin e mbyllur me 31.12.2021

"Kosto e punes " perfaqesojne pagat e personeli , sigurime shoqerore per pedagoget.

"Materialet e konsumuara " perfaqesojne materialet per kliniket dentare , barin, librarine dhe mesim dhenien ne Universitet si materialet e shitura per ndertimin e ndertesese nga firma ndertuese.

"Shpenzimet e tjera " Sherbime per mesimdhenien ne shumen 64.335.200 leke , Energji , uje dhe Naftë 13.109.485 leke , Taksa lokale 7.436.585 leke, Shpenzime per udhetime , dieta dhe transporti 20.526.987 leke, Riparime dhe Mirembajtje 7.408.611 , kuota e shpenzime te shperndara per vitin 2021 33.075.273 leke etj.

" Amortizimi per ndertesat dhe aktivet e tjera eshte llogaritur me metoden e vleres se mbetur dhe eshte ne vleren prej 169.461.086 leke si dhe me amortizimi per aktivet e mara me qera sipas IFRS 16 ne shumen prej 79.948.116 leke .

### 11. Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Te ardhurave me shpenzimet financiare per vitin 2021 dhe 2020 jane si me poshte ;

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2021	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020
Shpenzime nga Kurset e kembimit	(16,421,663)	(3,492,446)
Te Ardhura nga Kurset e kembimit	-	-
Shpenzime financiare per Interesa	(24,720,112)	(28,538,707)
Shpenzime per interesa te llogaritura per Qerate	(648,335)	(898,504)
<b>Shuma</b>	<b>(41,790,110)</b>	<b>(32,929,657)</b>

Gjate vitit 2020 ka pasur shpenzime per interesa per te Huave dhe shpenzime nga nga kurset e kembimit si rrjedhoje e luhatjeve te Euro-s nga 123.70 leke/Euro ne fillim te vitit ne 120.76 Leke /Euro ne fund te vitit. Bazuar ne IFRS 16 eshte llogaritur interesi per detyrimet e qerave qe eshte ne shumen prej 648.335 leke.

### 12. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Shpenzimet e tatimi mbi fitimin per ushtrimin kontabel 2021 dhe 2020 jane si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2021	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020
<b>I FITIMI NETO PARA TATIMIT</b>	<b>131,930,652</b>	<b>167,059,751</b>
<b>II SHPENZIME TE PAZBRITESHME (+)</b>	<b>11,045,090</b>	<b>219,941</b>
1 Amortizime tej normave fiskale	-	-
2 Shpezime pritje e dhurime tej kufirit tatimor	-	-
3 Gjoha, penalitete dhe te Tjera te Panjohura	11,045,090	219,941
<b>III PJESA E HUMBES SE MBARTUR(-)</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>IV FITIMI (HUMBJA) TATIMORE(I+II-III)</b>	<b>142,975,742</b>	<b>167,279,692</b>
<b>V Shpenzimi i tatim fitimit-15%</b>	<b>21,446,361</b>	<b>25,091,954</b>
<b>VI FITIMI NETO I USHTRIMIT(I-V)</b>	<b>110,484,291</b>	<b>141,967,797</b>



## Shenimet per Pasqyrat Financiare per vitin e mbyllur me 31.12.2021

Tatim fitimi i ushtrimit eshte i llogaritur mbi fitimin e tatushem sipas legjistacionit fiskal, analizuar ne tabelen e mesiperme. Tatim fitimi i paguar gjate vitit 2021 dhe bashke me gjendjen ne 31.12.2020 eshte ne shumen prej 25.552.328 leke dhe ne 31.12.2021 gjendja e tatimit te fitimit te mbipaguar eshte 4.105.967 Leke.

### **3- Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vazhdimesia e shfrytezimit**

Ngjarje te ndodhura pas dates se miratimit te pasqyrave financiare nuk ka . Gabime materiale te ndodhura ne periudhat e meparshme kontabel, te kostatuara gjate periudhes raportuese nuk ka.

Hartoi  
( \_\_\_\_\_ )

Per Drejtimin e Njesise Ekonomike

( \_\_\_\_\_ )  
( Administrator )

